

Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Ligjit Nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit dhe Statutin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për Periudhën e Përkohshme me nr. prot. 8648/24 dt.31.12.2024 dhe bazuar në Vendimin e Bordit Drejtues nr.10-BD/2025, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës shpall:

KONKURS

PËR DIZAJNIMIN E LOGOS SË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, fton të gjithë të interesuarit, për të gjeneruar dhe për të paraqitur idetë e tyre origjinale dhe inovative për LOGO-n e ardhshme zyrtare të Odës së Inxhinierëve. Kjo logo do të shërbejë si simbol identifikues i Odës dhe do të pasqyrojë misionin, vizionin dhe rolin e Inxhinierëve në shoqëri. Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga komisioni profesional i themeluar nga OIRK.

1. Veprimtaria e OIRK-së

Oda është organizatë profesionale jofitimprurëse e cila ka për qëllim rregullimin e profesionit të inxhinierit, me qëllim ruajtjen e shëndetit, sigurisë publike dhe mbrojtjen e mjedisit.

2. Kriteret e Kualifikimit

- Secili kandidat mund të paraqesë vetëm një propozim;
- Konkursi është i hapur për studentë të fakulteteve relevante, artist, dizajner grafik; arkitekt, etj.

3. Kriteret e Dizajnit të Logos

- Logoja duhet të pasqyrojë të tre disiplinat e inxhinierisë që mbulon Oda: Inxhinierinë e Ndërtimit, Inxhinierinë Elektrike dhe të Makinerisë që lidhen me fushën e ndërtimit.
- Logoja duhet të jetë krejtësisht origjinale, pa imitim të logos së ndonjë organizate tjetër inxhinierike.
- Dizajni duhet të jetë modern dhe i thjeshtë për t'u mbajtur mend.
- Ngjyra profesionale – Kombinime si kaltër, hiri, e bardhë dhe e verdhë mund të përfaqësojnë seriozitetin dhe teknologjinë.
- Kontrast i mirë – Duhet të duket qartë si në print ashtu edhe në versione digjitale.
- Tipografi moderne – Shkronja të forta dhe të lexueshme.
- Logoja duhet të funksionojë mirë në formate të ndryshme: materialet e printuara, web, uniforma, flamuj etj. (këto duhet të prezantohen në formë digjitale në konkurs)
- Duhet të duket mirë si me ngjyra, ashtu edhe bardh e zi.
- Për të identifikuar lidhjen me Kosovën, mund të përfshihet një element delikat kombëtar si psh: Forma stilizuar e hartës së Kosovës, e integruar në sfond ose në një detaj brenda logos.
- Me tekst të përshkruhet motivi i propozimit të llogos në konkurs.

4. Udhëzuesi për Përdorimin e Logos

Propozimit ideor të logos duhet t'i bashkëlidhet udhëzuesi me modelet e përdorimit në situata të ndryshme.

5. Dokumentacioni i kërkuar

Propozimi duhet të përfshijë

- Një dokument PDF me përshkrimin dhe filozofinë e dizajnit të logos;
- Një skedar JPG/PNG vetëm me logon;
- Të dhënat e plota të kontaktit të aplikuesit;
- Dosjet duhet të emërohen me një kod katërshifror;
- Logoja fituese duhet të dorëzohet në format vektor (Adobe Illustrator - AI ose EPS).

6. Shpërblimi

Trupi i jurisë do të zgjedhë vetëm çmimin e pare.

- Çmimi i pare 1800 Euro

7. Dorëzimi i Aplikimeve

Aplikacioni duhet të ketë mbishkrimin "Per dizajnimin ideor të logos së OIRK-së".

Zarfa 1: Mbishkrimi me Kod 4-shifror I cili përmban vetëm Propozimin (Print A4 + Digjitale)

Zarfa 2: Mbishkrimi me Kod 4-shifror i cili përmban Identifikimin e Propozuesit.

Të Dy këto zarfa të futen në një Zarfë të madhe ku shënohet vetëm Kodi 4-shifror dhe të dorëzohet personalisht ose me postë në adresën:

Adresa:

Kompleksi Rilindja, Kontejneri Nr.3, 10000

Prishtinë, Kosovë

E_mail: odaeinxhinierëve@gmail.com

8. Dorëzimi i Ofertave:

Data: 04.04.2025 – Ora: 10:00 deri në 14.00 në adresën Kompleksi Rilindja, Kontejneri Nr.3, 10000, Prishtinë, Kosovë

9. Shënime me rëndësi:

Logoja fituese do të bëhet identiteti vizual i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës. Në rast nevojë, logoja fituese mund të zhvillohet nga autori (në masë minimale), sipas propozimeve/ sugjerimeve nga juria profesionale, duke mos cenuar në asnjë mënyrë konceptin primar të logos. Me përzgjedhjen, të gjitha të drejtat i takojnë Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

Ju lutemi vini re: emri i plotë i institucionit është "Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës" dhe akronimi është "OIRK", ndërsa informata shtesë lidhur me veprimtarinë e saj mund të gjeni në Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit.